

HEART

HEART: Shërim dhe Edukim nëpërmjet Arteve

ÇFARË KEMI PARASYSH ME ARTE?

Kur mendojmë për artet, shumë nga ne mendojnë të pikturuarit, të vizatuarit – por ka shumë më shumë: të kënduarit, të vallëzuarit, të luajturit e instrumenteve muzikore, të aktruarit/teatro, skulptura me argjilë /plastelinë, ndërtim modelesh, tregim rrëfenjash, teatër kukullash, poezi, të shkruarit krijues. Të gjitha këto kanë rolin e tyre për të luajtur që t'i ndihmojnë fëmijët të zhvillohen nga pikëpamja konjitive (e njohjes), emocionalisht dhe shoqërisht. “Arti” promovon të vetë-shprehurit. Kjo është arsyeja që këto forma arti quhen arte shprehëse.

- Të vallëzuarit i mundëson fëmijëve që të përqendrohen më mirë në kohë dhe hapësirë dhe të ndjehen të pranishëm në trupin e tyre dhe në momentin aktual. Kjo prani mendore ndërton themelin tek fëmija. Lëvizja fizike dhe ekuilibri inkurajon zhvillimin e aftësive motorike bazë dhe ndihmon në forcimin e aftësive matematikore nëpërmjet të numëruarit e hapave dhe ritmeve të duartrokitjeve.
- Vizatimi inkurajon koncentrimin dhe iu lejon fëmijëve t'i shfaqin ndjenjat të cilat mund të jenë të fshehura, jo vetëm ndaj të tjerëve por edhe ndaj vetvetes.
- Mbajtja dhe përdorimi i një lapsi, lapustil, apo boje dhjami (crayons), inkurajon zhvillimin e aftësive të mira motorike.
- Të pikturuarit inkurajon një ndjenjë lirie ndërsa fëmijët ftohen që të eksperimentojnë me ngjyra dhe të zbulojnë të reja. Edhe kjo inkurajon zhvillimin e aftësive të mira motore.
- Muzika mund t'iu ofrojë fëmijëve mbështetje ndërsa i drejtojmë fëmijët drejt ushtrimeve relaksuese gjatë aktiviteteve të arteve. Kjo mund t'iu ofrojë fëmijëve edhe mundësinë të gjejnë zërin e tyre, nëpërmjet të kënduarit apo të luajturit të instrumenteve, dhe inkurajon punën në grup dhe koordinimin kur ata këndojnë së bashku. Muzika gjithashtu forcon aftësitë matematikore ndërsa fëmijët mësojnë të numërojnë goditjet ritmike, të memorizojnë ritme dhe harmoni kohore.
- Teatri dhe të treguarit e rrëfenjave/tregimeve u japin fëmijëve mundësinë për të krijuar tregime dhe t'i aktrojnë ato brenda një grupi. Aktrimi i një tregimi mund të jetë thellësisht shërues dhe transformues dhe ndihmon të inkurajohen aftësitë për zgjidhje problemesh. Aktrimi dhe drama mund të forcojnë leximin, kur tregimet shkruhen për të planifikuar shfaqje ose për t'u bërë libra tregimesh me tekst të shkruar dhe me figura të pikturuara.

ARSYETIMI: Pse artet?

Si i ndihmojnë artet fëmijën? Format e ndryshme të arteve të identifikuara më herët janë forma të “lojës” që nxisin imagjinatën e fëmijës. Kjo është gjuha e tyre natyrale. Nëpërmjet lojës, fëmijët përdorin kreativitetin e tyre ndërsa zhvillojnë imagjinatën, shkathtësinë dhe fuqinë fizike, njohëse dhe emocionale. Në disa kontekste, për arsye të ndryshme, fëmijët nuk kanë mundësi të angazhohen në këtë formë të të luajturit. Me orientimin e të rriturve të ndjeshëm, jo paragjykses, të gjithë fëmijët mund të mësojnë si të luajnë.

Kur luajnë dhe bëjnë aktivitete artistike (që mund të jenë të kënduarit, të pikturuarit, të vallëzuarit apo të aktruarit), fëmijët:

- Rrisin aftësitë e tyre për t’u përqendruar dhe për të punuar drejt një qëllimi;
- Zgjidhin probleme duke gjetur alternativa dhe duke bërë zgjedhje;
- Fitojnë një sens mjeshtërie duke arritur qëllimet përmes përpjekjeve të tyre;
- Ndërtojnë vetë-besimin dhe me të, dëshirën për t’u përballur me sfida të reja;
- Shkarkojnë tensionin dhe reduktojnë ankthin duke kanalizuar energjinë në aktivitete konstruktive;
- Komunikojnë idetë e tyre;
- Shprehin ndjenja që mund të jenë të vështira për t’u thënë
- Zhvillojnë aftësi motore bazë dhe të avancuara
- Zhvillojnë aftësi sociale (të dëgjuarit, të ndarit me të tjerët, bëjnë gjërat me radhë, të bashkëpunojnë).